



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 03/2011
Prishtinë, më 30. 03. 2011, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, dhe Biserka Kostić.

Mungoj: Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi – USAID dhe Shefi Kastrati - NDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie morina.

Mbledhjen e kryesoi kryetari.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryetari - theksoi që janë dy dokumente bazike Strategjia Legjislative e Qeverisë për vitin 2011 edhe Sfidat nga Raporti i Progresit, që duhet të përputhen me kohën e shqyrtimit të pikave që janë propozuara, dhe mbi këtë bazë duhet të hartohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2011. Po ashtu dhe aktivitetet e tjera që janë detyrime të Komisionit por edhe mund të ketë propozime tjera nga anëtarët e komisionit.

Teuta Sahatqija – propozoj që të fillohet me draftin e Planit të punës për vitin 2011, për aktivitetin e secilit muaj, pastaj do të shohim së çakë mund të ndryshohet për secilën muaj.

Visar Ymeri - kishte dy propozime që të jenë në planin e punës së komisionit për vitin 2011 si:
a. Mbikëqyrja e punës së Qeverisë sa po e zbaton strategjinë legjislative në ato pika që i ka propozuar dhe
b. Mbikëqyrja e projekteve të Infrastrukturës, siç është projekti për autostradën Kosovë – Shqipëri, së në çfarë masë po zbatohet kontrata me kompaninë Bektell- Enka.

Kryetari - tha që në fokusim është Plani i punës, që të hartohet mbi bazën e aktiviteteve të parapara që ka Komisioni funksional.

Hashim Deshishku - propozoj që t'i rekomandohet Qeverisë, për uljen taksave për lëndën e parë që hynë në doganat e Kosovës.

Kryetari - tha që për këtë çështje mund ta kemi një takim me përfaqësuesit e ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për të na njoftuar ma shumë për këtë çështje.

Hashim Deshishku- tha që nuk është në të mirë të zhvillimit ekonomik që buxheti i Kosovës të këtë të hyra po thuaj së vetëm nga taksat doganore.

Sala Berisha-Shala – tha që ta bëjmë një agjende me listë të projektligjeve në bazë të prioritetëve, që i duhen zhvillimit ekonomik të vendit. Dhe propozoj që disa projektligje të kërkohen që të sjellën ma shpejte nga Qeveria në Kuvend, siç janë: Projektligji për dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Projektligji për transformimin e pjesshëm të “Trepçës”- ndërmarrje në administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Lutfi Zharku - kërkoj që për muajin qershor që janë paraparë të realizohen 3 vizita punë në ministrit që i mbikëqyrë komisioni të hiqen 2 dhe të kalojnë në muaj maj dhe korrik. Sepse është ngarkuar shumë muaji qershor.

Pas disa diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Vendim

Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2011

3. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari - njoftoj anëtarët e Komisionit që ka pasur disa takime me organizata që e mbështesin Komisionin siç janë USAID-i dhe IDI-ja. Potenco i se këto dy organizata kanë premtuar që do të ndihmojnë me disa praktike dhe ekspertiza, që mund t'i përshtatën rrethanave tona.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit